R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i projektligjit "Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar" mbështetet në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Ky projektligj ka për qëllim uljen e çmimit të karburanteve në tregun vendas, nëpërmjet rishikimit të politikës fiskale dhe reduktimit të barrës tatimore, që ndikon drejtpërdrejt në çmimin e karburanteve. Në këtë kuadër, projektligji parashikon heqjen e taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin, me synim reduktimin e barrës tatimore mbi këto produkte, si dhe rishikimin e taksave që zbatohen mbi mjetet, në kuadër të ristrukturimit të skemës tatimore në sektorin e transportit.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje synohet krijimi i kushteve për uljen e çmimit të karburanteve për konsumatorët, lehtësimi i kostove të transportit për qytetarët dhe subjektet ekonomike, si dhe zbutja e ndikimit të këtyre kostove në çmimet e mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu, rishikimi i taksave të automjeteve synon të mundësojë një rishpërndarje të barrës tatimore, duke marrë në konsideratë nevojën për ruajtjen e qëndrueshmërisë së të ardhurave të buxhetit të shtetit.

Konkretisht, projektligji synon:

- heqjen e taksës së qarkullimit në masën 27 lekë për litër për benzinën e gazoilin, e cila, duke marrë në konsideratë edhe efektin e TVSH-së në masën 20%, sjell një reduktim të barrës tatimore mbi karburantet prej 32,4 lekë për litër;
- rishikimin e vlerës së taksës së përvitshme për automjetet luksoze;
- rishikimin e elementeve të formulës së taksës vjetore të mjeteve të përdorura të transportit;
- vendosjen e një takse fikse për mjetet elektrike në varësi të llojit;
- vendosjen e taksës për rimorkiot dhe gjysmërimorkio, në varësi të peshës së tyre.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar" është hartuar në kuadër të rishikimit të politikës tatimore, me qëllim reduktimin e barrës tatimore mbi karburantet dhe krijimin e kushteve për uljen e çmimit të tyre në tregun vendas.

1. Heqja e taksës së qarkullimit mbi benzinën e gazoilin

Karburantet përbëjnë një element të rëndësishëm në strukturën e shpenzimeve të qytetarëve dhe të kostove të veprimtarisë ekonomike, për shkak të përdorimit të tyre të gjerë në sektorin e transportit, në veprimtaritë prodhuese, bujqësore dhe në ofrimin e mallrave e shërbimeve. Për rrjedhojë, luhatjet e çmimeve të karburanteve ndikojnë drejtpërdrejt në kostot e transportit, prodhimit dhe shpërndarjes, të cilat mund të reflektohen në çmimet përfundimtare të mallrave dhe shërbimeve, duke ndikuar në fuqinë blerëse të konsumatorëve dhe në veprimtarinë e subjekteve ekonomike.

Tregu vendas i karburanteve ndikohet nga zhvillimet në tregjet ndërkombëtare të naftës dhe nënprodukteve të saj, luhatjet e kursit të këmbimit, kostot e furnizimit dhe të transportit, si dhe detyrimet fiskale, që zbatohen mbi këto produkte.

Gjatë vitit 2026, luhatjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare të hidrokarbureve janë reflektuar edhe në tregun vendas, duke nxjerrë në pah nevojën për ndërmarrjen e masave për zbutjen e ndikimit të tyre në ekonomi.

Në përgjigje të kësaj situate, me vendimet nr.186, datë 19.3.2026, dhe nr.711, datë 16.9.2026, "Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve", Këshilli i Ministrave ka shpallur situatën e veçantë në tregun e hidrokarbureve, duke mundësuar zbatimin e mekanizmit të kufizimit të përkohshëm të çmimeve të tregtimit të karburanteve.

Në këtë kuadër, Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë dhe Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit ka ushtruar veprimtarinë e tij nëpërmjet përcaktimit të çmimeve maksimale të

tregtimit, me qëllim garantimin e transparencës në formimin e çmimeve, kufizimin e marzheve bruto të tregtimit dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Ndërsa mekanizmi i Bordit të Transparencës përbën një instrument të përkohshëm për administrimin e çmimeve në kushtet e një situate të veçantë, rishikimi i politikës fiskale mundëson një ndërhyrje të drejtpërdrejtë në barrën tatimore, që ndikon në formimin e çmimit të karburanteve. Në këtë kontekst, vlerësohet e nevojshme ndërmarrja e ndryshimeve në legjislacionin fiskal, me synim krijimin e kushteve për uljen e çmimit të karburanteve në tregun vendas.

Në strukturën e çmimit të karburanteve në tregun vendas, një peshë të rëndësishme zënë detyrimet fiskale, që zbatohen mbi këto produkte, përkatësisht akciza, taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH). Këto detyrime ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e çmimit përfundimtar të benzinës dhe gazoilit, ndërsa nivelet përkatëse të taksimit për vitin 2026 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.1 – Detyrimet fiskale mbi benzinën dhe gazoilin, viti 2026

Lloji i detyrimit	Benzinë	Gazoil
Akciza	39,376230 lekë/litër	39,376230 lekë/litër
Taksa e qarkullimit	27 lekë/litër	27 lekë/litër
Taksa e karbonit	1,5 lekë/litër	3 lekë/litër
TVSH	20%	20%

*Shënim: TVSH-ja në masën 20% zbatohet mbi bazën e tatueshme, e cila përfshin edhe detyrimet përkatëse tatimore.

Në kuadër të ndryshimeve të propozuara, parashikohet heqja e taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin, duke reduktuar barrën tatimore mbi këto produkte me 27 lekë për litër. Duke marrë në konsideratë edhe efektin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), në masën 20%, heqja e kësaj takse sjell një reduktim të barrës tatimore në çmimin përfundimtar të karburanteve prej 32,4 lekësh për litër, nga të cilat 27 lekë përfaqësojnë taksën e qarkullimit dhe 5,4 lekë efektin e TVSH-së mbi këtë taksë.

Ky ndryshim krijon kushtet për uljen e çmimeve të tregtimit të benzinës dhe gazoilit në tregun vendas. Reflektimi i reduktimit të barrës tatimore në çmimet përfundimtare do të varet nga faktorët e tjerë, që ndikojnë në formimin e tyre, përfshirë çmimet ndërkombëtare të karburanteve, kursin e këmbimit, kostot e furnizimit dhe të shpërndarjes, si dhe kushtet e tregut.

Nga pikëpamja ekonomike dhe sociale, ulja e çmimit të karburanteve pritet të ndikojë në lehtësimin e shpenzimeve të qytetarëve për transportin e reduktimin e

kostove të veprimtarisë ekonomike, veçanërisht në sektorët e transportit, prodhimit, bujqësisë dhe shërbimeve, duke krijuar kushte për uljen e kostove të mallrave e të shërbimeve dhe përmirësimin e kushteve të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.

Të ardhurat e parashikuara nga taksa e qarkullimit për vitin 2027 rezultojnë rreth 26.0 miliardë lekë, ndërsa të ardhurat nga TVSH-ja e aplikuar mbi këtë taksë, rreth 5,2 miliardë lekë, pra, në total, rreth 31.2 miliardë lekë.

2. Rishikimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura të transportit dhe të taksave mbi automjetet luksoze

Në kuadër të rishikimit të politikës fiskale në sektorin e transportit, krahas heqjes së taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin, projektligji parashikon ndryshime në taksimin e mjeteve të transportit, me synim rishpërndarjen e barrës tatimore dhe kompensimin e efekteve negative në të ardhurat buxhetore, që rrjedhin nga heqja e kësaj takse.

Ndryshimet e propozuara konsistojnë në rritjen e taksës së përvitshme të automjeteve luksoze, ndryshimin e elementeve të llogaritjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura të transportit, vendosjen e taksave vjetore për mjetet elektrike, rimorkiot dhe gjysmërimorkiot, si dhe rishikimin e shpërndarjes së të ardhurave, që arkëtohen nga taksat përkatëse.

2.1. Rritja e vlerës së taksës së përvitshme për automjetet luksoze.

Lidhur me taksimin e automjeteve luksoze, propozohet rritja e taksës së përvitshme për këtë kategori automjetesh me 19 000 lekë/vit, nga 21 000 lekë, që është aktualisht, në 40 000 lekë/vit.

Kjo masë synon rishikimin e nivelit të taksimit të automjeteve luksoze, në funksion të një diferencimi më të drejtë të barrës fiskale ndërmjet kategorive të ndryshme të automjeteve, duke marrë në konsideratë karakteristikat e veçanta të kësaj kategorie.

Rishikimi i vlerës së taksës së përvitshme nga 21 000 lekë në 40 000 lekë parashikohet të gjenerojë të ardhura në buxhetin e shtetit, të vlerësuara në rreth 0,43 miliardë lekë në vit.

2.2. Rishikimi i elementeve të formulës së taksës vjetore të mjeteve të përdorura të transportit

Lidhur me taksën vjetore të mjeteve të përdorura të transportit, propozohet rishikimi i elementeve të formulës së llogaritjes së saj, përkatësisht taksës fikse, sipas llojit të karburantit dhe koeficientëve sipas vjetërsisë së mjeteve.

Sipas legjislacionit në fuqi, taksa vjetore llogaritet duke shumëzuar cilindratën e mjetit me koeficientin sipas vjetërsisë dhe taksën fikse sipas llojit të karburantit, e cila është 12,5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Këto nivele janë përcaktuar me ligjin nr.120/2013.

Nëpërmjet projektligjit propozohet ndryshimi i taksës fikse, sipas llojit të karburantit, duke e përcaktuar, si më poshtë vijon:

a) Taksa fikse për llojin e karburantit është 25 lekë për naftën, 20 lekë për benzinën dhe 20 lekë për gazin për mjetet me vëllim deri në 2 000 cm^3, për autoveturë, motomjet ATP (sipas grupit I të koeficientit të vjetërsisë) dhe gjithë të tjerat (APV) (sipas grupit II të koeficientit të vjetërsisë);
b) Taksa fikse për llojin e karburantit është 26 lekë për naftën, 21 lekë për benzinën dhe 21 lekë për gazin për mjetet me vëllim më të madh se 2 000 cm^3, për autoveturë, ATP (sipas grupit I të koeficientit të vjetërsisë) dhe gjithë të tjerat (APV) (sipas grupit II të koeficientit të vjetërsisë);
c) Taksa fikse për llojin e karburantit është 25 lekë për naftën, 20 lekë për benzinën dhe 20 lekë për gazin, për autobusët (sipas grupit III të koeficientit të vjetërsisë).

Gjithashtu, propozohet rishikimi i koeficientëve sipas vjetërsisë së mjeteve, të përcaktuar në shtojcën nr.1 të ligjit, duke ruajtur diferencimin sipas kategorive dhe vjetërsisë së tyre, si dhe zgjerimi i bazës së taksimit nëpërmjet përfshirjes së mjeteve me vjetërsi nga 0 deri në 3 vjet, të cilat aktualisht nuk janë subjekt i kësaj takse.

Rishikimi i elementeve të formulës së llogaritjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura të transportit, nëpërmjet ndryshimit të koeficienteve sipas vjetërsisë së mjeteve dhe taksës fikse sipas llojit të karburantit, parashikohet të sjellë të ardhura totale të arkëtuara në buxhetin e shtetit, të vlerësuara në rreth 32.3 miliardë lekë në vit.

2.3. Taksë fikse për mjetet elektrike në varësi të llojit të tyre

Projektligji parashikon vendosjen e një takse vjetore fikse vjetore për mjetet elektrike në varësi të llojit të tyre. Konkretisht, parashikohet taksë fikse vjetore:

a) 15 000 lekë mjetet elektrike autoveturë, ATP (sipas grupit I të koeficientit të vjetërsisë), gjithë të tjerat (APV) (sipas grupit II të koeficientit të vjetërsisë) dhe autobusë (sipas grupit III të koeficientit të vjetërsisë); si dhe
b) 1 000 lekë motomjetet elektrike (sipas grupit I të koeficientit të vjetërsisë).

Ndryshe nga mjetet që përdorin karburante, për të cilat taksa vjetore llogaritet në bazë të cilindratës, vjetërsisë dhe llojit të karburantit, për mjetet elektrike propozohet një detyrim vjetor në shumë fikse. Ky ndryshim synon përfshirjen e mjeteve elektrike në skemën e taksimit vjetor, duke kontribuuar në zgjerimin e bazës së taksimit.

Vendosja e taksës vjetore fikse për mjetet elektrike, në masën 15 000 lekë dhe 1 000 lekë, sipas kategorive përkatëse, parashikohet të sjellë një efekt pozitiv në të ardhurat e arkëtuara në buxhetin e shtetit, të vlerësuar në rreth 0,24 miliardë lekë në vit.

2.4. Vendosja e taksës për rimorkiot dhe gjysmërimorkiot

Parashikohet vendosja e një takse vjetore për rimorkiot dhe gjysmërimorkiot, të diferencuara sipas peshës së tyre, përkatësisht:

- 1 lek për kilogram për rimorkiot dhe gjysmërimorkiot me peshë deri në 50 000 kg;
- 60 000 lekë taksë fikse vjetore për rimorkiot dhe gjysmërimorkiot me peshë mbi 50 000 kg.

Nëpërmjet këtij ndryshimi synohet përfshirja e rimorkiove dhe e gjysmërimorkiove në skemën e taksimit vjetor, duke përcaktuar një nivel taksimi të diferencuar sipas peshës së tyre. Për mjetet me peshë deri në 50000 kg, detyrimi tatimor llogaritet në përpjesëtim me peshën, ndërsa për mjetet që tejkalojnë këtë prag parashikohet një taksë fikse vjetore.

Kjo ndërhyrje synon zgjerimin e bazës së taksimit të mjeteve të transportit dhe krijimin e të ardhurave shtesë, në funksion të kompensimit të efekteve financiare që rrjedhin nga heqja e taksës së qarkullimit.

Vendosja e taksës vjetore për rimorkiot dhe gjysmërimorkiot, të diferencuara sipas peshës së tyre, parashikohet të sjellë një efekt pozitiv në të ardhurat e buxhetit të shtetit, të vlerësuar në rreth 0,31 miliardë lekë në vit.

2.5. Ndryshimi i normave të shpërndarjes së të ardhurave nga taksat e mjeteve të transportit për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe agjentët e taksave

Sipas legjislacionit në fuqi, 25% e të ardhurave nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura i kalojnë buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore, ndërsa agjenti i mbledhjes së taksave të mjeteve DPTSHRR përfiton një komision në masën 5%.

Nëpërmjet projektligjit propozohet reduktimi i pjesës së të ardhurave, që u kalon njësive të vetëqeverisjes vendore nga 25% në 5%, si dhe ulja e komisioneve të agjentëve të mbledhjes së taksave DPSHTRR nga 5% në 1.8% për kategoritë përkatëse të përcaktuara në ligj.

Megjithëse ndryshimet e propozuara parashikojnë reduktimin e përqindjeve të shpërndarjes së të ardhurave, rritja e konsiderueshme e të ardhurave të pritshme nga taksimi i mjeteve të transportit parashikohet të kompensojë këtë reduktim.

Për rrjedhojë, pavarësisht uljes së përqindjeve përkatëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe agjentët e mbledhjes së taksave pritet të përfitojnë të ardhura në vlera të përafërta ose më të larta në vlerë absolute krahasuar me nivelin aktual. Kjo pasqyrohet edhe në tabelën në vijim:

Bazuar në parashikimet për vitin 2027	**Aktualisht (viti 2025)**		**Propozohet në projektligj**	
	normë	**vlerë**	**normë**	**vlerë**
të ardhurat e agjentëve nga taksa e mjeteve	5%	405,883,000	1.8%	**651,455,818**
të ardhurat e pushtetit vendor	25%	1,777,230,000	5%	**1,724,5 54,504**

Këto ndryshime synojnë rishikimin e mënyrës së shpërndarjes së të ardhurave të arkëtuara nga taksimi i mjeteve të transportit, duke rritur pjesën që i kalon buxhetit të shtetit dhe duke kontribuuar në kompensimin e efekteve financiare të ndryshimeve të propozuara.

Në tërësi, nga ndryshimet e propozuara në taksimin e mjeteve të transportit, të ardhurat vjetore që parashikohen të arkëtohen në buxhetin e shtetit, pa përfshirë pjesën e të ardhurave që u takon agjentëve të mbledhjes së taksave dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, vlerësohen në rreth 33,8 miliardë lekë, nga rreth 7,2 miliardë lekë, që parashikohet të arkëtohen në vitin 2026 nga skema aktuale në fuqi, duke sjellë një rritje të të ardhurave prej rreth 26,6 miliardë lekësh në vit.

Në këtë mënyrë, të ardhurat e parashikuara rezultojnë të rriten 3,7 herë më shumë se niveli aktual. Kjo rritje synon të kompensojë efektin negativ buxhetor, që rrjedh nga heqja e taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin, si dhe të kontribuojë në ruajtjen e qëndrueshmërisë së të ardhurave buxhetore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar" përbëhet nga 7 nene, të cilat, në mënyrë të përmbledhur, parashikojnë si vijon:

Neni 1 parashikon shfuqizimin e pikës 2, të nenit 3, të ligjit, duke hequr taksën e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin nga kategoritë e taksave kombëtare.

Neni 2 parashikon ndryshime në nenin 4, të ligjit, konkretisht:

a) shfuqizimin e pikës 2, duke hequr taksën e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin prej 27 lekësh/litër.
b) ndryshimin e pikës 3, duke ndryshuar taksën fikse për naftën dhe për benzinën:

   i. Taksa fikse për llojin e karburantit është 25 lekë për naftën, 20 lekë për benzinën dhe 20 lekë për gazin për mjetet me vëllim deri në 2 000 cm^3, për autoveturë, motomjet ATP (sipas grupit I të koeficientit të vjetërsisë) dhe gjithë të tjerat (APV) (sipas grupit II të koeficientit të vjetërsisë);
   ii. Taksa fikse për llojin e karburantit është 26 lekë për naftën, 21 lekë për benzinën dhe 21 lekë për gazin për mjetet me vëllim më të madh se 2 000 cm^3, për autoveturë, ATP (sipas grupit I të koeficientit të vjetërsisë) dhe gjithë të tjerat (APV) (sipas grupit II të koeficientit të vjetërsisë);
   iii. Taksa fikse për llojin e karburantit është 25 lekë për naftën, 20 lekë për benzinën dhe 20 lekë për gazin, për autobusët (sipas grupit III të koeficientit të vjetërsisë).

c) Gjithashtu, parashikohet vendosja e taksave fikse vjetore për mjetet elektrike dhe motomjetet elektrike, përcaktimi i taksave për rimorkiot dhe

gjysmërimorkiot, si dhe ulja nga 25% në 5% e pjesës së të ardhurave, që u kalojnë njësive të qeverisjes vendore.

ç) Ndryshimi i pikës 11, taksë e përvitshme në masën 40 000 lekë çdo vit dhe duke parashikuar aplikimin e gjobës për çdo vit, sipas ligjit për procedurat tatimore në rastin e mospagimit në afat të taksës për automjetet luksoze.

Neni 3 parashikon shfuqizimin e shkronjës "b", të nenit 5, të ligjit, duke hequr administratën doganore nga cilësia e agjentit për arkëtimin e taksës së qarkullimit, në përputhje me shfuqizimin e kësaj takse.

Neni 4 parashikon ndryshime në pikën 2, të nenit 8, të ligjit, duke shfuqizuar shkronjën "b", që përcakton komisionin për arkëtimin e taksës së qarkullimit.

Gjithashtu, parashikohet ulja e normës së komisionit që përfitojnë agjentët e taksave, nga 5% në 1.8% për taksat e përcaktuara në shkronjat "c" dhe "g" të kësaj pike.

Neni 5 parashikon ndryshimin e pikës 6, të nenit 9, të ligjit, duke hequr referencën për taksën e qarkullimit nga dispozita, që rregullon përjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare, në përputhje me shfuqizimin e kësaj takse.

Neni 6 parashikon zëvendësimin e shtojcës nr.1 të ligjit me shtojcën e re nr.1, që i bashkëlidhet projektligjit, e cila përcakton koeficientët sipas vjetërsisë së mjeteve për llogaritjen e taksës vjetore të mjeteve të përdorura.

Neni 7 përcakton hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2027.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikohet të ketë një efekt negativ në të ardhurat buxhetore me rreth minus 5 miliardë lekë.

KËSHILLI I MINISTRAVE